



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1 Drake vendos bast 1.5 milionë dollarë për Argjentinën, rikthehet frika nga 'mallkimi i këngëtarit'
- 2 Lushnje/ Aksident me vdekje në aksin Çermë-Divjakë, humb jetën 38-vjeçar! 4 të plagosur, mes tyre 2 fëmijë (EMRI+VIDEO)
- 3 Moderatorja e njohur shtatzënë për herë të tretë? (FOTO)
- 4 Botërori 2026/ Sonte shkruhet historia, do të luhet finalja Spanjë-Argjentinë! Messi
- 5 Sukeset nuk kanë fund për tël Ja triumfi i radhës i Dua Lipës në Britani

Kronikë

Shkodër/ Dyshohet se do t'i bënin atentat Preng Gjinit, një i arrestuar dhe një tjetër në kërkim! Policia gjen eksploziv të lidhur me celular (EMRAT)

Sipas burimeve Buraku ka deklaruar eksplozivin ia ka lënë në makinë shoku i tij Eduart Përgjoka, i shpallur në kërkim. Në banesën e Përgjokës blutë gjetën disa telefona celularë, karta Sim dhe kapsolla detonatore. Në celularin e Euglen Burakut është gjetur në telefon fotoja e Preng Gjinit.



Preng Gjini

Redaksia 19 Korrik, 15:44 | Përditesimi: 19 Korrik, 18:12

Share Post WhatsApp



Policia e Shkodrës ka arrestuar [Euglen Buraku](#) në Vaun e Dejës, nën dyshimin për një [atentat](#) të mundshëm ndaj Preng Gjinit. Sipas burimeve ai është ndaluar në Vaun e Dejës disa ditë më parë.

Nga kontrolli i automjetit, blutë gjetën një sasi lënde plasëse e lidhur me celular. Sipas burimeve Buraku ka deklaruar se ia ka lënë në makinë shoku i tij [Eduart Përgjoka](#), i shpallur në kërkim.

Në banesën e Përgjokës blutë gjetën disa telefona celularë, karta Sim dhe kapsolla detonatore. Në celularin e Euglen Burakut është gjetur fotoja e Preng Gjinit, për të cilin ka deklaruar fillimisht se e kishte kushëri, gjë e cila ka rezultuar më pas e rreme. Po ashtu i është gjetur dhe fotoja e një biznesmeni (ndërtues) për të cilën Buraku ka thënë se nuk e njhte, por ia kishte dërguar Përgjoka.

[Sh].com LEXO EDHE: **Shiroka mahnit të huajt! Pamjet, mikpritja e gatimet 'joshin' turistët: Vendi më i bukur që kam vizituar!**

Të njëjtat burime bëjnë me dije se [Preng Gjini](#) jeton jashtë vendit, por ditët e fundit kishte hyrë në Shqipëri dhe dyshohet se po mbahej në vëzhgim. Policia e Shkodrës ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Në 2020-ën 56-vjeçari i shpëtoi një **atentati të mirëorganizuar** mbi urën e Selitës. Në atë kohë makinës së tij i vendosën tritol të një sasive 400 gram C4 në pjesën e përparme të makinës. Shpërthimi ndodhi ndërsa ai ishte duke udhëtuar.

Atentati para 6 vitesh mendohet se lidhet me **sagën e hakmarrjeve** mes dy fiseve Gjini dhe Reçi në Rrëshen, por Gjini e ka mohuar këtë fakt. Preng Gjini është vëllai i Armando ose Tonin Gjinit nga qyteti i Rrëshenit, i cili mbeti i vrarë në 12 gusht 2019. Armando Gjini, i kishte shpëtuar më parë dhe një atentati me tritol, pasi fatmirësisht arriti ta pikasë në kohë lëndën eksplozive.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Xh.K/P.J/Shqiptarja.com

TAG: preng gjini atentat Shkoder Euglen Buraku Eduart Përgjoka

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh].com **Sondazhi i ditës:** Finalja Spanjë-Argjentinë, kush e fiton Kupën e Botës? 18 Korrik, 19:55

Spanja Argjentina Nuk kam mendim

Lajme të tjera



Kampioni i boksit Nelson Hysa zgjedh plazhin e Velipojës për të kaluar pushimet, fton edhe qytetarët ta vizitojnë

19 Korrik, 15:01




19 vite burg, familja s'ia hap derën nga frika e gjakmarrjes! Vrasja që e përndjek 63-vjeçarin, i vetëm në malet e Pukës



Armir Mehaj

19 Korrik, 12:56



Shkodër/ Të shtëna me armë zjarri në Barbullush pas një konflikti mes disa personave

19 Korrik, 07:35



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, 39-vjeçari arrestohet në Malësi të Madhe

18 Korrik, 11:06



Atentati në Sarandë/ 9 plumba drejt Thimjo Rubatit, autorët me skafandra ikën me skaf! Gjendet motori që përdorën! 50-vjeçari: S'i njoha



Limos Didani

18 Korrik, 09:24



Garat në Tiranë dhe Shkodër – analizë paraprake



Eduard Zaloshnja

17 Korrik, 20:23




Shkodër, Beci inspektor rikonstruktimin e markatës së 'Rusit': Do të kemi një treg brenda standardeve europiane




Ergys Kavaja

17 Korrik, 15:52



Prag tragjdie në Shkodër, guri shkëputet nga një masiv shkëmbor dhe bie mbi makinën me turistë! Thyen baxhanë dhe përfundon brenda automjetit

17 Korrik, 10:36



Plagosja me thikë e 32-vjeçarit brenda poliklinikës në Shkodër, pamje nga momenti kur nisi sherri! I ati i 18-vjeçarit sulmon i pari me grushte (VIDEO)

16 Korrik, 22:53




I riu plagos me thikë 32-vjeçarin në Shkodër, i vëllai tenton të vrasë autorin, vihet në pranga! Arrestohet edhe 18-vjeçari e i ati (VIDEO)

16 Korrik, 13:18



Abuzimi me çmimet e shezlongëve, bashkia Shkodër kontrole në plazhin e Velipojës! Penalitete për bizneset që abuzojnë

16 Korrik, 11:55



Iu gjenden në banesë 4 armë zjarri dhe municion, arrestohet 21-vjeçari në Shkodër (VIDEO)

16 Korrik, 08:53



×

Sh

.com

Lajmi i fundit



Drake vendos bast 1.5 milionë dollarë për Argjentinën, rikthehet frika nga 'mallkimi i këngëtarit'

19 Korrik, 18:54